



# **BISHZ - VAIS - UIAS**

**BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR**  
**VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ**  
**UNION DES INTELLECTUELS ALBANAIS EN SUISSE**  
**UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA**

Seftigenstrasse 57 • 3017 Bern 17

---

## **Raporti vjetor nr. 3**

---

**BISHZ - VAIS - UIAS**

**12.12.1999 - 31.12.2000**

Id. i dokumentit	E:\BISHZ\SEKRETARIATI\RAPORTI-03.DOC
Klasifikimi:	Vetëm për shfrytëzim të brendëshëm
Krijuesi:	<b>BISHZ</b>
Data e krijimit:	30.12.2000
Firma:	Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër (BISHZ)
Është shtypur më:	30.12.2000
Emri i fajllës:	<b>RAPORTI-03.DOC</b>
U shpërndahet:	Anëtarëve të BISHZ-së
Data e shpërndarjes:	<b>31.12.2000</b>

# Përmbajtja

Faqe

1.	Lidhur me këtë dokument .....	3
1.1.	Qëllimi dhe dokumentet përcjellëse .....	3
1.2.	Shkurëtesat .....	3
1.3.	Azhurimi i dokumentit .....	4
1.4.	Kontrolla dhe lëshimi në përdorim .....	4
1.5.	Krijimi dhe kontrolla e ndryshimeve .....	4
2.	Qëllimi dhe detyrat e BISHZ-së .....	5
2.1.	Qëllimi .....	5
2.2.	Detyrat .....	5
3.	Kryesia .....	5
4.	Sekretariati .....	8
5.	Seksionet e BISHZ-së .....	8
5.1.	Seksioni për shëndetësi .....	8
5.1.1.	Projektet .....	9
5.2.	Seksioni për teknikë .....	10
5.2.1.	Projektet .....	10
5.3.	Seksioni për çështje juridike .....	10
5.4.	Seksioni për ekonomi .....	10
5.5.	Seksioni për çështje sociale .....	11
5.6.	Seksioni për diplomaci-politikë .....	11
5.7.	Seksioni për informim .....	11
5.8.	Seksioni për kulturë .....	11
5.9.	Seksioni për sport .....	11
5.10.	Seksioni për arsim .....	11
5.11.	Seksioni për përkthime .....	12
5.12.	Veprimtaria botuese .....	13
6.	Tribunat dhe promovimet .....	14
7.	Organizimi i protestave .....	14
8.	Paraqitjet e BISHZ-së në media .....	14
9.	Botimet e brendëshme të BISHZ-së .....	15
10.	Bilanci i BISHZ-së për vitin 1999 .....	16
11.	Lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së .....	17

## 1. Lidhur me këtë dokument

Ky dokument paraqet raportin e aktivitetit të BISHZ-së në periudhën 12.12.1999 deri më 31.12.2000. Ky është një dokument operativ i cili përcjellë punën e anëtarëve të kryesisë së BISHZ-së / Udhëheqësve-Zëvendësudhëheqësve të seksioneve të BISHZ-së, grupeve dhe komisioneve të caktuara të BISHZ-së.

### 1.1. Qëllimi dhe dokumentet përcjellëse

Ky dokument vlenë për Kuvendin e BISHZ-së.

Dokumenti bazohet në:

- Raportin nr. 3 të Nazmi Jakurti të datës 09.12.2000
- Qëllimet e BISHZ-së për vitin 2000/2001
- Statutin e BISHZ-së
- Programin e punës së BISHZ-së
- Vendimet e marrura nga mbledhjet e kryesisë, sekretariatit, seksioneve, grupeve punuese dhe komisioneve të caktuara të BISHZ-së.
- Prezantimi i BISHZ-së
- Bilanci i BISHZ-së për vitin 2000

### 1.2. Shkurtesat

BISHZ	Bashkimi i intelektualëve shqiptarë në Zvicër	VAIS	Vereinigung der albanischen Intellektuellen in der Schweiz
UIAS	Union des intellectuels albanais en Suisse	UIAS	Unione intellettuali albanesi in Svizzera
KRYE	Kryesia e BISHZ-së	SEK	Sekretariati i BISHZ-së
SHËN	Seksioni për shëndetësi	TEK	Seksioni për teknikë
JUR	Seksioni për çështje juridike	EKO	Seksioni për ekonomi
SOC	Seksioni për çështje sociale	DPO	Seksioni për diplomaci-politikë
INF	Seksioni për informim	KUL	Seksioni për kulturë
SPO	Seksioni për sport	AR	Seksioni për arsim
PËRK	Seksioni për përkthime	VP	Veprimtaria botuese
KST	Komisioni statutar	KKR	Komisioni i kontroll-revizionit
AK	Anëtarë të kryesisë	US	Udhëheqës i seksionit
ZUS	Zëvendësudhëheqës i seksionit	UP	Udhëheqës i projektit
BPP	Bashkëpunëtor i projektit	ADM	Administrator
AN	Anëtar	ANN	Anëtar Nderi

### 1.3. Azhurimi i dokumentit

Ky dokument mund të zgjerohet me kërkesën e Kuvendit të BISHZ-së. Ky është poashtu bazë për krijimin e versioneve të reja.

Dokumenti është i përgatitur në formë të decentralizuar në shërbyesin e BISHZ-së.

### 1.4. Kontrolla dhe lëshimi në përdorim

Detyra	Emri	Data	Nënshkrimi / Leja
Kontrollë	BISHZ	30.12.2000	BISHZ
Lëshimi në përdorim	BISHZ	31.12.2000	BISHZ

### 1.5. Krijimi dhe kontrolla e ndryshimeve

Versioni	Data	Autori	Vërejtje
1.0	08.12.2000	N. Jakurti	Aktiviteti i BISHZ-së në periudhën prej 12.12.1999 deri më 08.12.2000
2.0	31.12.2000	A. Xhigoli	<ul style="list-style-type: none"><li>• Strukturimi i të dhënave sipas raporteve të mëparshme dhe përfshirja e të dhënave të paraqitura</li><li>• Plotësimi i raportit me vërejtjet e dhëna në Kuvendin e tretë</li><li>• Plotësimi i raportit me pjesën financiare (Balanci i BISHZ-së për vitn 2000)</li></ul>

## 2. Qëllimi dhe detyrat e BISHZ-së

### 2.1. Qëllimi

Në bazë të statutit, qëllimi themelor i BISHZ-së është që të bashkoj potencialin intelektual shqiptar në Zvicër dhe atë ta vë në shërbim të çështjes kombëtare në përgjithësi dhe të komunitetit shqiptar në Zvicër. Këto synime BISHZ i sendërton nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive kulturore, projekteve profesionale e shkencore dhe tribunave të ndryshme.

### 2.2. Detyrat

Detyrë themelore e BISHZ-së (anëtarëve-këshiltarëve të kryesisë së BISHZ-së / Udhëheqësve-Zëvendësudhëheqësve të seksioneve të BISHZ-së, grupeve punuese) është që konkretisht të angazhohen në organizimin e mbajtjes së tribunave dhe realizimin e projekteve të caktuara në programin e punës të aprovuar nga Kuvendi i BISHZ-së.

## 3. Kryesia

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I KRYESISË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	11.12.1999	Mbledhja e Kuvendit të dytë të rregullt të BISHZ-së	<p>Mbledhja e Kuvendit të dytë të rregullt të BISHZ-së është mbajtur hotelin Löwen (Bernstrasse 28, 310 Münsingen) të shunën më 11 dhjetor 1999.</p> <p>Pjesëmarrës në Kuvend kanë qenë reth 40 anëtarë.</p> <p><b>Rendi i ditës</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>Përshëndetja e të pranishmëve – hapja e Kuvendit. Paraqitja e anëtarëve të Kryesisë, leximi i rendit të mbledhjës</li><li>Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 05.12.1998 -10.12.1999</li></ul> <p>Në pjesën e parë dr. sc. Ahmet Xhigoli përmes folive paraqiti raportin e aktivitetit të BISHZ-së për periudhën e përmendur. Në pjesën e dytë, zonja Florije Rexhaj paraqiti raportin financiar për të njëjtën periudhë, kurse në pjesën e tretë, zotëri Nazmi Jakurti paraqiti gjendjen e projektit BISHZ-BAG. Në vazhdim, në pjesën e katërt të kësaj pike, dr. Xhigoli dha gjendjen e tashme lidhur me nxjerrjen e revistës “Bashkimi”.</p> <p>Pastaj është debatuar lidhur me raportin dhe pjesët e tij. Në përfundim të kësaj pike, raporti është aprovuar në tërësi.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>Zgjedhja e kryesisë së re sipas nenit 7.c. dhe zgjedhja e komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 7.d. të Statutit të Shoqatës.</li></ul> <p>Në këtë pikë pas përfundimit të diskutimeve me drejtë vote është zgjedhur Kryesia e re prej nëntë anëtarëve. Kryetar është zgjedhur Nazmi Jakurti, nënkryetar Xhevat Salihu, sekretar Sinollah Shehu, kurse arkëtar Ismet Rexhaj.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>Të ndryshme</li></ul> <p>Në këtë pikë është dhënë një pikë muzikore nga Grupi muzikor „Arbëria“ në Bernë dhe kryetari, dr. sc. Ahmet Xhigoli i ka ndarë tri mirënjohje (dy për administratorët e BISHZ-së: Ismet Rexhaj dhe Adnam Mehmetit dhe një për Shoqërinë kulturore-artistike „Naim Frashëri“ në Bernë)</p>		AX
					AX, Nj, FR
					Të gjithë
					AX

			Në fund të punimeve të Kuvendit të dytë të rregullt, Sekretariati i BISHZ-së, ka organizuar një koktej për të pranishmit. Mbledhja ka zgjatur prej orës 14:00 deri në ora 17:00.		
02	Prill 2000	Marrëveshje	<u>Marrëveshja BISH-Qendra Shqiptare</u> Në prill të vitit 2000 është arritur marrëveshja në mes të BISHZ-së dhe Qendrës Shqiptare në Seftigenstr. 57 në Bernë, që BISHZ-ja të ketë selinë e re të saj në lokalet e QSH-së. Obligimet e BISHZ-së për këtë marrëveshje janë pagesa e shumës prej 1000 SFr. në vit, kurse. Të drejtat e sajë janë bashkëshfrytëzimi i sallave duke përfshirë këtu edhe një zyre për sekretariatit e BISHZ.		NJ, Stefan Enggist
03	09.09.2000	Takim i BISHZ-së	<u>Takimi BISHZ-LSHB</u> Më datën 09.09.2000 është zhvilluar një takim në mes të BISHZ-së dhe Lidhjes Shqiptare në Botë, dega në Zvicër e cila në atë kohë ishte në fazën e formimit. Takimin e ka organizuar N. Jakurti. Takimi është mbajtur në Qendrën Shqiptare në Bernë. Pjesëmarrës në këtë takim nga ana e LSHB-së ishin: Simon Kuzhnini, Ali Nikoliqi, Bexhet Sallahu, Lan Avdiu dhe Avni Jakurti, kurse nga ana e BISHZ-së: N. Jakurti (kryetar), Xh. Salihu (nënkryetar), S. Shehu (sekretar), I. Rexhaj (arkëtar), A. Xhigoli (këshilltar) dhe A. Mehmeti (administrator). Takimi ka pasur karakter vizite dhe ka zgjatur 1 orë e 20 minuta. Në këtë takim vizitë, të pranishmëve u'a kemi paraqitur shoqatën tonë (historikun, aktivitetet e deritanishme dhe planet për vitin 2000-2001). Nga ana e LSHB-së, jemi njoftuar me programin dhe aktivitetet e tyre. Pas kryerjes së vizitës të gjithë kemi shkuar për të ngrënë ushqim në një restorant shqiptar afër Rothrist-it.		NJ, XHS, AX, IR, AM
04	18.11.2000	Mbledhja e parë e kryesisë së BISHZ-së	Mbledhja e kryesisë së BISHZ-së është mbajtur në lokalet e Qendrës Shqiptare në Seftigenstrasse 57 në Bernë, të shunën më 18 nëntor 2000 prej orës 13.00 deri në ora 17.30. <b><u>Pikat e rendit të mbledhjes:</u></b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshëndetja e të pranishmëve, leximi i rendit të mbledhjes dhe sqarimi për qëllimin e kësaj mbledhje të Kryesisë të propozuar nga A. Xhigoli më 7.11.2000.</li> <li>• Strategjia e BISHZ-së për vitin 2000/2001 Parqitja e dokumentit me titull "Qëllimet e BISHZ-së për vitin 2000/2001" të përpiluar nga këshilltari i BISHZ-së, dr.sc. Ahmet Xhigoli dhe diskutimi i tij. Në këtë pikë janë diskutuar 6 pikat e përfshira në dokumentin e përmendur (Përfundimi i projektit BAG; Botimi i Revistës shkencore, kulturore, artistike dhe sportive "Bashkimi"; Selia e re BISHZ-së në Qendrën Shqiptare; Organizimi dhe anëtarësia; Projektet, kualiteti)</li> <li>• Projektet për vitin 2001 Në këtë pikë janë diskutuar: Propozimet e Projekteve për vitin 2001; Nxjerrja e numrave të tjerë të Revistës shkencore, kulturore, artistike dhe sportive "Bashkimi"; Kontaktet me BAG për mundësitë e bashkëpunimit të mëtutjeshëm; Organizimi i javës së Kulturës Kosovare në Zvicër në fund të muajit mars 2001; Organizimi i katër tribunave të BISHZ-së; Projektet interne të seksionit për teknikë</li> <li>• Raporti i Kryesisë së BISHZ-së për vitin 2000 Në këtë pikë është dhënë një informatë lidhur me gjendjen e përpilimit të raportit nr. 3 të BISHZ-së janë dhënë nga N. Jakurti. Është theksuar që formësimi i raportit nr. 3 të jetë i ngjashëm me</li> </ul>	Dokument	NJ  AXH  Të gjithë  NJ

			<p>raportet e mëparshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detaryt e pa kryera Në këtë pikë janë diskutuar detyrat të cilat duhet të kryehen sa më parë, si: sktualizimi i kontos së BISHZ-së me nënshkrimet të reja, paraqitjet e ndrrimeve të reja në „Handelsregister“; evidentimi me shkrim i pagesave të pakryera; pagesa e dy biletave ndaj puntorit të Kosova Reisen në Cyrih.</li> <li>• Përgatitjet për Kuvendin e tretë të rregullt të BISHZ-së Në këtë pikë temë diskutimi ka qenë mbajtja e Kuvendit të tretë të rregullt i BISHZ-së (caktimi i datës së mbajtjes, dërgimi i ftesave me pikat e rendit të mbledhjes anëtarëve të BISHZ-së dhe musafirëve, organizimi i koktejit, etj.)</li> <li>• Të ndryshme Për shkak të disa mosmarrveshjeve të bëra në mes të BISHZ-së dhe LSHB-së, në këtë pikë është diskutuar kjo temë dhe nga kryesia e ngushtë është kërkuar që të përpillohet një marrëveshje për bashkpunim në mes të BISHZ-së dhe LSHB-së dhe në bazë të saj të punohet. Nga ana e BISHZ-së nënshkrues të marrëveshjes së përmendur të jenë kryetari, nënkryetari dhe sekretari.</li> </ul>		<p>Të gjithë</p> <p>Të gjithë</p> <p>NJ, XHS, SSH</p>
05	24.11.2000	Takime të BISHZ-së	<p><u>Takime të BISHZ-së me subjekte të ndryshme</u> Më 24.11.2000, BISHZ-ja si pjesë e delegacioni të përbërë me musafirët e përmendur dhe nga LSHB-ja dega në Zvicër ka zhvilluar takime në Komisaratin e lartë për të drejtat e njeriut pranë OKB-së (Zyra e zonjes Mary Robinson), në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq si dhe në përfaqësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës pranë OKB-së në Gjenevë. Kryesuesi i delegacionit ka qenë Dr. Pajazit Nushi. Në këto takime janë paraqitur të dhëna dhe fakte për pafajsinë e pengjeve shqiptare të luftës, inkompetencën e shtetit serb për t'i mbajtur ata dhe nevojën urgjente dhe mundësitë e intervenimit të zyrtarëve ndërkombëtarë për t'i dhënë fund kësaj drame shqiptare.</p>		NJ, XHS, AX
06	Shator 2000	Takime të BISHZ-së me subjekte të ndryshme në Kosovë	<p><u>Takime të BISHZ-së me subjekte të ndryshme në Kosovë</u> Në përgatitjet për mbajtjen e kësaj proteste BISHZ ishte e përfaqësuar (përmes kryetarit N. Jakurti) në delegacionin i cili udhëtoi në Kosovë për t' u informuar nga afër me problemin si dhe për të kë përkrashjen e udhëheqjes së UNMNIK-ut dhe të subjektit politik e jopolitik shqiptarë të Kosovës për kërkesat e protestes. Me këtë rast në Kosovë, u pritëm nga administratori i OKB-së në Kosovë, zoti Bernard Kushner, nga kryetari i akademisë së shkencave dhe arteve të Kosovës, Akademik Nexhat Daci, kryetari i LDK, zoti dr. sc. Ibrahim Rugova; kryetari i PSHDK-së akademik Mark Krasniqi, zëdhënësi i PQLK zoti Reshat Sahitaj, kryetari i këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut prof. dr. sc. Pajazit Nushi, kryetarja e këshillit për organizimin e protestave në Kosovë zonja Shukrije Rexha, kryetari i shoqatës së ish të burgosurve politik në Kosovë zoti Berat Luzha, kryetari i shoqatës së gazetarëve të pavarur të Kosovës, zoti Haqif Mulliqi, nga kryesia e këshillit të prindërve të të burgosurve dhe të të zhdokurve në Gjakovë, si dhe kontaktua me përfaqësues të PDK dhe AAK në Zvicër dhe në Kosovë.</p>		NJ

**Problemet:** Gjat vitit 2000, kryetari i BISHZ-së nuk ka treguar angazhim të duhur siq është pritur.

**Masat e ndërmarrura:** Bisedë me kryetarin dhe anëtarët e kryesisë së ngushtë.

#### 4. Sekretariati

AKTIVITETI I GJERËTANISHËM I SEKRETARIATIT					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	20.11.2000	Përgatitjet për Kuvendin e tretë të rregullt	<u>Përgatitjet për Kuvendin e tretë të rregullt</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dërgimi i thirrjeve për Kuvend</li> <li>Lista e evidencës së pjesëmarrësve</li> <li>Flamuri, foto-aparati dhe kamera për inçizim</li> <li>Rregullimi i një tavoline (sekretariat të improvizuar)</li> <li>Formulari për regjistrim të anëtarëve të rinjë dhe formulari për donator (50 kopje)</li> <li>Minutat e rrjedhës së Kuvendit dhe diskutimi përshëndetës me rastin e hapjës së Kuvendit</li> <li>Raporti (50 kopje) dhe lidhja e tyre dhe folitë për paraqitje</li> <li>Përgatitja e dokumenteve për paraqitjen e ndrrimeve në "Handelsregister" në Bernë</li> <li>Aktualizimi i Konto-s së BISHZ-së me nënshkrimet të reja (N. Jakurti, S. Shehu, Xh. Salihu, I. Rexhaj)</li> <li>Drafti i marrëveshjes për bashkpunim në mes të BISHZ-së dhe LSHB-së</li> <li>Kryerja e pagesat e të pakryera deri më tani</li> <li>Organizimi i koktejit: Sigurimi i pijeve dhe transporti i tyre deri në Qendrën Shqiptare</li> </ul>		NJ SSH IR IR  AXH  NJ, XHS  NJ, IR   NJ, XHS, SSH NJ, XHS, SSH NJ  IR, IR, AXH

**Problemet:** Sigurimi i mjeteve financiare për funksionim të suksesëshëm.

**Masat e ndërmarrura:** Nuk janë marrur kurfarë masash.

#### 5. Seksionet e BISHZ-së

##### 5.1. Seksioni për shëndetësi

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR SHËNDETËSI					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

**Problemet:** Gjat vitit 2000, në këtë seksion nuk është zhvilluar kurfarë aktiviteti.

**Masat e ndërmarrura:** Udhëheqjen e projektit të BAG-së e ka marrë për sipër Sekretariati i BISHZ-së



### 5.1.1. Projektet

<b>Projekti:</b> Preventiva e varësisë (keqpërdorimit të drogave) dhe Sidës në klubet sportive shqiptare në Zvicër ("Aids- und Suchtprävention bei den albanischen Jugendlichen unter besonderer Berücksichtigung der Sportvereine in der Schweiz")		
<b>Bashkëpunëtorët e projektit:</b>		
<b>BAG:</b>	Thomas Spang, përgjegjës kryesor për realizimin e projektit; Verena Hanselmann; Dr. Afrim Kurtani	
<b>BISHZ:</b>	Dr.sc. Ahmet Xhigoli, përgjegjës kryesor për realizimin e projektit; Fil. i dipl. Gjuliano Iseinei, udhëheqës i projektit (deri më 15.02.1999); Jur. i dipl. Nazmi Jakurti, udhëheqës i projektit (prej datës 12.02.1999 deri në përfundim Dr. Xhevat Salihu, ligjërues; Abas Fejzullahi, ligjërues; Dr. Enver Pula, ligjërues; Alban Nevzati, ligjërues; Naim Morina, ligjërues; Fahri Mahalla, bashkëpunorë; Ismet Rexhaj, bashkëpunorë; Adnan Mehmeti, bashkëpunorë; Llokman Beqiri, bashkëpunorë; Dr. Rezane Ferizi, ligjëruese; Inxh, i dipl. Fatos Ferizi, ligjërues	
<b>Përshkrimi i projektit:</b>	Shiko Raportin nr. 1 (29.11.97 - 4.12.98)	
<b>Projekti ka filluar më: 01.11.1998</b>		<b>Projekti ka përfunduar më: 30.06.2000</b>
<b>Lgjeratat e mbajtura:</b>	<b>Lista e ligjeratave të mbajtuara</b>	<b>Data e kryerjes:</b>
	1. Luzern , Klubi i të rinjëve "Jugendtreff Piazzeta" në Luzern, pjesëmarrës 12 (ligjërues: Alban Nevzati / Naser Morina)	27.11.1998
	2. Balsthal, Klubi „Xhemë Gostivari“, pjesëmarrës 30 (ligjërues Fatos Ferizi)	13.02.1999
	3. Badgutenburg, Klubi Futbollistik „Struga 97“, pjesëmarrës 28 (ligjërues Fatos Ferizi)	20.02.1999
	4. Olten, ligjërata është mbajtur në adresën Aarburgerstr. 141, 4600 Olten, pjesëmarrës 13 vajza (ligjëruese Rezana Ferizi)	16.05.1999
	5. Olten, ligjërata është mbajtur në adresën Reiserstr. 20, 4600 Olten, pjesëmarrës 15 vajza (ligjëruese Rezana Ferizi)	02.06.1999
	6. Oberbuchsiten, ligjërata është mbajtur në adresën Hauptstr. 130, 4625 Oberbuchsiten, pjesëmarrës 17 gra (ligjëruese Rezana Ferizi)	07.07.1999
	7. Winterthur, Klubi „Dugagjini“, pjesëmarrës 15 (ligjërues Fatos Ferizi)	09.10.1999
	8. Littau, Selia e LDK-së, pjesëmarrës 17 (ligjërues Fatos Ferizi)	23.10.1999
	9. St. Gallen, Shoqata "Guri i Zi", pjesëmarrës 53 (ligjërues Fatos Ferizi)	06.11.1999
	10. Zofingen, Klubi „Kafeteria Bäckerei“, pjesëmarrës 25 (ligjërues Fatos Ferizi)	07.11.1999
	11. Lugano, Klubi „Art Atelie“, pjesëmarrës 16 (ligjërues Fatos Ferizi)	13.11.1999
	12. Grenchen, ligjërata është mbajtur në adresën Karl Mathy-Str. 28, Grenchen, pjesëmarrës 14 (ligjërues Abaz Fejzullahu)	26.10.1999
	13. Biberist, ligjërata është mbajtur në një shtëpi të refugjatëve shqiptarë në Biberist, pjesëmarrës 14 (ligjërues Abaz Fejzullahu)	26.11.1999
	14. Sofenwil, Klubi Futbollistik Shqiptarë në Sofenwil, pjesëmarrës 12 (ligjërues Nazmi Jakurti)	28.11.1999
	15. Sierre, Klubi shqiptarë "Haxhi Zeka", pjesëmarrës 35 (ligjërues Abaz Fejzullahu)	02.12.1999
	16. Neuchatel, Klubi Shqiptarë "Kosova", pjesëmarrës 24 (ligjërues Abas Fejzullahi)	17.12.1999
	17. Solothurn, Allmendstr. 75, pjesëmarrës 10 (ligjërues Abas Fejzullahi)	18.02.2000
	18. Croix de Roson, Klubi shqiptarë FC „Kosova“, pjesëmarrës 15 (ligjërues Abas Fejzullahi)	19.02.2000
	19. Meyrin, Klubi shqiptarë FC „Liria“, pjesëmarrës 21 (ligjërues Abas Fejzullahi)	20.02.2000
	20. Lausanne, Klubi shqiptarë FC „Dardania“, pjesëmarrës 8 (ligjërues Abas Fejzullahi)	20.02.2000
	21. Basel, Këshillimorja Shqiptare, pjesëmarrës 14 (ligjërues Dr. Enver Pula)	10.03.2000
	22. Basel, Këshillimorja Shqiptare, pjesëmarrës 15 (ligjërues Dr. Enver Pula)	17.03.2000
	23. Brig, Klubi shqiptarë në Brig, pjesëmarrës 17 (ligjërues Abas Fejzullahi)	29.04.2000
	24. Martigny, Cafe Restaurant de la Gare, pjesëmarrës 27 (ligjërues Dr. Xhevat Salihu)	13.05.2000
	25. Sion, Cafe de la Gare, pjesëmarrës 19 (ligjërues Dr. Xhevat Salihu)	14.05.2000
<b>Seminaret e mbajtura për shkollim të mediatorëve:</b>	<b>Seminaret e mbajtura për shkollim të mediatorëve</b>	<b>Data e kryerjes:</b>
	1. Cisap-Bern, Freiburgstr.139c, Bern; Seminar i parë për shkollim të mediatorëve. Seminari është mbajtur më 01.04.00 / 09.00 –16.00. Pjesëmarrës 5, ligjërues Dr. Xhevat Salihu.	01.04.2000
	2. Cisap-Bern, Freiburgstr.139c, Bern; Seminar i dytë për shkollim të mediatorëve. Seminari është mbajtur më 06.05.00 / 09.00 –16.00. Pjesëmarrës 5, ligjërues Dr. Xhevat Salihu.	

Tribunat e mbajtuara:	<u>Tribunat e mbajtuara</u> 1. Qendra Shqiptare, Seftigenstr. 57, 3000 Bern; Tribuna Profesionale BISHZ-BAG. Tribuna është mbajtur më 19.05.00/13.30–18.00. Pjesëmarrës 36; Referues: jur. idipl. Nazmi Jakurti, dr. sc. Ahmet Xhigoli, dr. Enver Pula, dr. Xhevat Salihu (BISHZ), Verena Hanselmann (BAG), dr. Ilir Tolaj, dr. Afrim Blyta (UNI Prishtinë, Kosovë), inxh. i dipl. Fatos Ferizi (bashkëpuntorë i jashtëm). 2. Gundeli Casino in Basel, Gundelistr., 4053 Basel; Tribunë publike e BISHZ-BAG. Tribuna është mbajtur më 20.05.00/19.00–21.30; Pjesëmarrës 57; Referues: dr. Enver Pula, dr. Xhevat Salihu (BISHZ); dr. Ilir Tolaj, dr. Afrim Blyta (UNI Prishtina). 3. Qendra Shqiptare „Përparimi“ në Cyrih, Albulastr. 40, 8048 Zürich; Tribunë publike e BISHZ-BAG. Tribuna është mbajtur më 21.05.00 / 19.00 – 21.30. Pjesëmarrës: 41. Referues: dr. Enver Pula, dr. Xhevat Salihu (BISHZ); dr. Ilir Tolaj, Afrim Blyta (UNI Prishtina).	Data e kryerjes: 19.05.2000  20.05.2000  21.05.2000
Themelimi i një grupi-bërthamë:	<u>Themelimi i një grupi-bërthamë</u> Për aktivitetet e mëtejme në kuadër të projektit të përmendur, në tribunën e mbajtur në Bernë, më 19.05.2000, është themeluar grupi-bërthamë në përbërje dr. Xhevat Salihu (BISHZ), dr. Enver Pula (BISHZ), dr. Ilir Tolaj (Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë), dr. Afrim Blyta (Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë), dhe një vend është embetur i hapur për një anëtar nga BAG.	Data e kryerjes: 19.05.2000
Raporti përfundimtar:	<u>Raporti përfundimtar</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i realizimit të projektit në 11 faqe dhe shtojca e pjesës së deklaratimit të shpenzimeve i është dërguar zonjës Verena Hanselmann në adresën: Bundesamt für Gesundheit Dienst Migration, 3003 Bern më 30.06.2000.</li> <li>Letra e BISHZ-së lidhur me vëretjet e BAG-së, znj. Verena Hanselmann në letrën e saj të datës 22.08.2000, i është dërguar zonjës së përnendur më 31 tetor 2000.</li> </ul>	Data e kryerjes: 30.06.2000  31.11.2000
Aprovimi definitiv i projektit:	<u>Aprovimi definitiv i projektit</u> Projekti është aprovur definitivisht. Më tepër shiko letrën e znj. Verena Hanselmann lidhur me aprovimin definitiv të projektit të BAG-BISHZ, realizimin e të cilit e ka bërë BISHZ-ja.	Dhjetor 2000

## 5.2. Seksioni për teknikë

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR TEKNIKË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
–	—	—	—	—	—

**Vërejtje:** Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.3. Seksioni për çështje juridike

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR ÇËSHTJE JURIDIKE					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
–	—	—	—	—	—

**Vërejtje:** Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.4. Seksioni për ekonomi

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR EKONOMI					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	31.12.2000	Bilanci i BISHZ-së"	Gjendja e bilancit të BISHZ-së për periudhën 01.01.2000 – 21.12.2000	Dokumet	AX, IR

## 5.5. Seksioni për çështje sociale

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR ÇËSHTJE SOCIALE					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

Vërejtje: Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.6. Seksioni për diplomaci-politikë

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR DIPLOMACI-POLITIKË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

Vërejtje: Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.7. Seksioni për informim

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR INFORMIM					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

Vërejtje: Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.8. Seksioni për kulturë

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR KULTURË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

Vërejtje: Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.9. Seksioni për sport

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR SPORT					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

Vërejtje: Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.10. Seksioni për arsim

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR ARSIM					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

Vërejtje: Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.11. Seksioni për përkthime

AKTIVITETI / PROJEKTET E SEKSIONIT PËR PËRKTHIME					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
—	—	—	—	—	—

Vërejtje: Në këtë seksion nuk është zhvilluar kurëfarë aktiviteti.

## 5.12. Veprimtaria botuese

AKTIVITETI / PROJEKTET E VEPRIMTARI BOTUESE TË BISHZ-SË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	15.12.1999	Takim me autorët e punimeve	<u>Takim i fundit me autorët e punimeve të aprovuara</u> Qëllim i i takimit - Korigjimi gjuhësor i punimeve - Korigjimi i biografive - Caktimi definitiv i shtypshkronjës për shtypjen e revistës - Formimi i librezave për anëtarët e redaksisë	Protokol	AX
02	11.01.2000	Letër-kërkesë	Kërkesë për ndarjen, respektivisht regjistrimin e numrit ISSN për revistën e ardhshme të BISHZ-së. Kërkesa për ndarje të numrit të përmendur është dërguar në qendrën ISSN-Zentrum Schweiz në Bernë më 11 janar 2000. Kërkesën e ka bërë kryeredaktori i revistës dr.sc. A. Xhigoli.	Fax-Letër-kërkesë	AX
03	11.01.2000	Përgjegjëje	Përgjegjëja pozitive e zonjës Ch. Schmidt nga Bundesamt für Kultur, Schweizerische Landesbibliothek në Bernë, e datës 11.01.00, në të cilën pozivisht e vërteton ndarjen e numrit ISSN 1424-65554, gjegjësisht të regjistrimit të revistës.	Letër	Zonj. Ch. Schmidt
04	29.1.200	Takim i parë	Takimi i parë lidhur me përgatitjet për shtypjen e revistës. Pjesëmarrës në takim: A. Xhigoli, Xh. Salihu, F. Ziri. Takimi është mbajtur në lokalet e shtypshkronjës në Monthey.	Kontrolla e shtypjes	AX, XHS, FZ
05	31.01.2000	Takim i dytë	Takimi i dytë lidhur me fillimin e shtypjes së kopjeve të para të revistës. Pjesëmarrës në takim: A. Xhigoli, Xh. Salihu, F. Ziri. Takimi është mbajtur në lokalet e shtypshkronjës në Monthey. Përgatitjet për shtypjen e revistës	Kontrolla e shtypjes	AX, XHS, FZ
06	26.02.2000	Takim i tretë	Takimi i tretë lidhur me dhënjën e lejës definitive, shtypshkronjës, për shtypjen e 1000 kopjeve të revistës "Bashkimi",	Dokument-Marrëveshje	AX, XHS, FZ
07	18.03.2000	Mbledhja e redaksisë së revistës	Mbledhja e redaksisë së revistës është mbajtur në lokalet e shkollës CISAP në Bernë. <u>Qëllimi i mbledhjes:</u> - Përgatitjet për organizimin e ceremonisë së promovimit të Revistës "Bashkimi" më 01.04.2000/15:00 -17:00. - Përpilimi i komunikatës në shqip - Përpilimi i komunikatës në gjermanisht Pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët e këshillit të redaksisë.	Protokol	AX  Të gjithë  AX AX
08	01.04.2000	Promovimi i revistës "Bashkimi"	<u>Promovimi i revistës "Bashkimi"</u> Më 01.04.2000 në lokalet e Qendrës Shqiptare në Bernë u bë promovimi i numrit të parë të revistës "Bashkimi". Me këtë rast, kryeredaktori i revistës dr.sc. Ahmet Xhigoli i përshëndeti të pranishmit dhe bëri paraqitjen e anëtarëve të Redaksisë dhe pastaj të pranishmit u ftuan në një koktej rasti. Numri i parë u prit jashtëzakonisht mirë nga intelektualët e pranishëm në këtë ceremonie. Për nivelin shkencorë e profesional dhe formësimin e	Komunikata në shqip dhe gjermanisht	AX

			revistës, marrëm lada nga shumë personalitete. Numri i pjesëmarrësve ishte rreth. 50.	
--	--	--	---	--

**Problemet:** Momentalisht mungojnë mjetet financiare.

**Masat e ndërmarrura:** Kërkimi i donatorëve.

## 6. Tribunat dhe promovimet

TRIBUNAT DHE PROMOVIMET					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	19.05.2000	Tribunë profesionale	<p>Tribunë profesionale në mes të BISHZ-BAG në temën: “ Parandalimi i SIDA-s dhe varshmërisë tek të rinjtë shqiptarë, me theks të vecantë në klubet sportive”. Tribuna është mbajtur në Bernë në lokalet e Qendrës Shqiptare. Pjesëmarrës: 36.</p> <p><u>Programi i Tribunës (13:30–18:00)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Paraqitje e shkurtër i BISHZ-së (A. Xhigoli)</li> <li>• Angazhimi i Entit Federal për Shëndetësi në mbrojtjen e shëndetit të emigrantëve ( V. Hanselmann/BAG)</li> <li>• Të rinjtë shqiptarë në Zvicër dhe problemi i varshmërisë dhe SIDA-s ( E. Pula )</li> <li>• Problemi i SIDA-s në Kosovë (I. Tolaj, UP-FM, Kosovë)</li> <li>• Problemi i narkomanisë në Kosovë ( A. Blyta, UP-FM, Kosovë )</li> <li>• Komuniteti shqiptarë në Zvicër i organizuar mirë, si preventivë ndaj SIDA-s dhe varshmërisë (Xh. Salihu)</li> <li>• Sporti si preventivë ndaj varshmërisë ( F. Ferizi)</li> <li>• Bisedë rreth temës dhe këmbim përvojash (Të gjithë).</li> </ul> <p>Për aktivitetet e mëtejme në kuadër të projektit BISHZ-BAG, gjatë punës së tribunës është themeluar një grup-bërthamë, në përbërje dr. Xhevat Salihu (BISHZ), dr. Enver Pula (BISHZ), dr. Ilir Tolaj (Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë), dr. Afrim Blyta (Fakulteti i Mjekësisë, Prishtinë), dhe një vend është embetur i hapur për një anëtar nga BAG.</p>	Punimet e paraqitura të referuesëve	Sekretariati i BISHZ-së
02	20.05.2000	Tribunë e parë publike	<p>Organizimi i tribunës së parë publike në Basel me publikun shqiptarë në temën: “Problemi i SIDA-s dhe Narkomanisë në Kosovë dhe në Zvicër“. Organozator i tribunës është BISHZ-ja në bashkëpunim me Entin Federal për Shëndetësi (BAG). Tribuna është mbajtur në lokalet e “Gundelidinger-Casino”, Güterstrasse 213, në Basel më 20.05.00/19.00–21.30; Pjesëmarrës: 57; Referues: Dr. Ilir Tolaj, Dr. Afrim Blyta (Universiteti i Prishtinës).</p>		Sekretariati i BISHZ-së
03	21.05.2000	Tribunë e dytë publike	<p>Organizimi i tribunës së dytë publike në Cyrih me publikun shqiptarë në temën: “Problemi i SIDA-s dhe Narkomanisë në Kosovë dhe në Zvicër“. Organozator i tribunës është BISHZ-ja në bashkëpunim me Entin Federal për Shëndetësi (BAG). Tribuna është mbajtur në lokalet e Qendrës Shqiptare “Përparimi“, Albulastr. 40, në Cyrih më 21.05.00/19.00–21.30. Pjesëmarrës: 41. Referues: Dr. Ilir Tolaj, Dr. Afrim Blyta (Universiteti i Prishtinës).</p>		Sekretariati i BISHZ-së
05	21.09.2000	Tribunë e tretë publike	<p>BISHZ-ja sëbashku me Universitetin Popullor Shqiptar në Gjenevë dhe Lidhjen Shqiptare në Botë, dega në Zvicër më 21.09.2000 në lokalet e UPSH-</p>		NJ, XHS

			së në Gjenevë ka organizuar tribunën publike, në temën „Aktualitete politike shqiptare“ me pjesëmarrës anëtarë e delegacionit nga Kosova dhe Shqipëria.		
06	23.09.2000	Promovim	BISHZ-ja sëbashku me Këshillimorën Shqiptare në Basel më 23.09.2000, ka organizuar promovimin e dy librave: „Lufta për të mbetur njeri “ autor Pjetë Arbnori dhe „Kosova nën administrimin ndërkombëtar“ autor Prof. Dr. Esat Stavileci, si dhe me organizimin e tribunës publike në Basel në temën "Aktualitete politike shqiptare".		NJ, SSH, AX
07	Shtator 2000	Promovim-Pjesëmarrje	<u>Pjesëmarrje në promovim</u> Pjesëmarrja në rastin e dyvjetorit të rënjes së komandantit të UCK Shaban Golajt.		NJ

## 7. Organizimi i protestave

PROTESTAT E ORGANIZUARA NGA BISHZ-JA					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	21.09.2000	Organizim proteste	<u>Organizimi i protestës</u> Më 21.09.2000, BISHZ-ja sëbashku me Universitetin Popullor Shqiptar në Gjenevë dhe Lidhjen Shqiptare në Botë, dega në Zvicër kanë organizuar protestën në Gjenevë, në të cilën është kërkuar liri i menjëhershëm dhe i pakusht i të gjithë të burgosurve shqiptarë në burgjet serbe, ndriçimi i fatit të të zhdukurve dhe njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Kosovës. Në këtë protestë kanë marrë pjesë edhe mysafirët e ftuar: Prof. Dr. Pajazit Nushi (kryetar i KMDLNJ), zoti Pjeter Arbnori (ish kryetar i Parlamentit të Shqipërisë), Akademik Esat Stavileci (profesor në Universitetin e Prishtinës), vëllëzërit Simon dhe Mikel Kuzhnini (Udhëheqës të Lidhjes shqiptare në botë), zoti Ramiz Zekolli (kryetar i Lidhjes shqiptare në botë për shtetet e Beneluksit), zoti Ali Nikoliqi (kryetar i Lidhjes shqiptare në botë për Zvicër), zoti Berat Luzha (kryetar i shoqatës së ish të burgosurve politik në Kosovë), zonja Shukrije Rexha (kryetare e këshillit për organizimin e protestave në Kosovë) si dhe dy nëna, (përfaqesuese të nënave të të zhdukurve dhe të burgosurve në Kosovë).		NJ, XHS, AX, IR

## 8. Paraqitjet e BISHZ-së në media

BOTIMET E BRENDESHME TË BISHZ-SË					
Nr.	Data	Lloji i aktivitetit	Përshkrimi	Dokumenti i lëshuar	Përgjegjës
01	20.05.2000	Informatë	Informatë e publikuar në gazetën Bota Sot, Koha Ditore, Eurozëri, idhur me oraganizimin e tribunës publike me publikun shqiptarë në Basel në temën: “Problemi i SIDA-s dhe Narkomanisë në Kosovë dhe në Zvicër“ me ekspertët shqiptarë nga Prishtina, Dr. Ilir Tolaj dhe Dr. Afrim Blyta dhe ekspertët shqiptarë nga Zvicra, Dr. Xhevat Salihu dhe Dr. Enver Pula. Informatën e ka përgatitur N. Jakurti.	Informatë	Bota Sot, Koha Ditore, Eurzëri
02	21.05.2000	Informatë	Informatë e publikuar në gazetën Bota Sot, Koha Ditore, Eurozëri, idhur me oraganizimin e tribunës publike me publikun shqiptarë në Cyrih në temën: “Problemi i SIDA-s dhe Narkomanisë në Kosovë dhe në Zvicër“ me ekspertët shqiptarë nga Prishtina, Dr.	Informatë	Bota Sot, Koha Ditore, Eurzëri

			Ilir Tolaj dhe Dr. Afrim Blyta dhe ekspertët shqiptarë nga Zvicra, Dr. Xhevat Salihu dhe Dr. Enver Pula. Informatën e ka përgatitur N. Jakurti.		
03	22.05.2000	Artikull	Paraqitja e BISHZ-së përmes artikullit të Arbër Ahmetaj me titull: "Dy agresorë të rrezikshëm në Kosovë: SIDA dhe Narkomania". Artikulli i përmendur është botuar në Bota Sot më 22.05.2000.	Artikull	Bota Sot

## 9. Botimet e brendëshme të BISHZ-së

BOTIMET E BRENDESHME TË BISHZ-SË			
Nr.	Data	Titulli i botimit	Përshkrimi
01	30.06.2000	<b>Projekti: Preventiva e Varësisë (Keqpërdorimit të Drogave) dhe Sidës në klubet sportive Shqiptare në Zvicër, Dispencë, BISHZ-Bernë, Qershor 2000, Fq. 32.</b>	Dokumenti përshkruan realizimin e projektit.
02	18.10.2000	<b>Qëllimet e BISHZ-së për vitin 2000/2001, Bernë, 2000. BAZA-SH, Dispencë, BISHZ-Bernë, 2000.</b>	Dokumenti përshkruan qëllimet e BISHZ-së për periudhën 2000-2001.
03	30.12.2000	<b>Bilanci për vitin 2000, BISHZ-Bernë, 2000.</b>	Dokumenti paraqet të dhënat e bilancit për vitin 2000 të BISHZ-së.
04	30.12.2000	<b>Raporti vjetor nr. 3, BISHZ-Bernë, 2000.</b>	Dokumenti përshkruan aktivitetin e BISHZ-së për periudhën në periudhën prej 12.12.1999 deri më 31.12.2000.

## 10. Bilanci i BISHZ-së për vitin 2000

<b>10.1. Të ardhurat nga anëtarësia, donatorët, kreditorët dhe veprimtaria e seksioneve</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Shuma në Fr.</b>	<b>Vërejtje:</b>
1.	Të ardhurat nga anëtarësia për vitin 2000	900.00	Anëtarësia
2.	Këthimi i depozitit nga firma Wotrewa AG	3'089.65-	Depoziti
3.	Pagesa nga "Winterthur-Versicherung". (Pagesa e dëmit me rastin e thyrjes së lokalit të BISHZ-së në Fabrikstr. 36, Bern)	12'000.00	Pagesa e dëmit
4.	Kamata për vitin 2000 e kontos së BISHZ-së	4.30	Kamata
<b>Gjithsej të ardhurat hryëse në BISHZ për vitin 2000:</b>		<b>15'993.95</b>	
<b>10.2. Shpenzimet e përgjithshme për periudhën janar – dhjetor 2000</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Qëllimi i shpenzimit</b>	<b>Shuma në Fr.</b>	<b>Vërejtje:</b>
1.	Qiraja e lokalit në Fabrikstrasse 36, Bernë (janar-shkurt 2000)	1'500.00	Qiraja
2.	Qiraja një vjeçare paushall e lokalit në Seftigenstrasse 57, Bernë	1'000.00	Qiraja
3.	Shpenzimet e shtypjes së 1000 kopjeve të revistës "Bashkimi"	7'800.00	Revista
4.	Shpenzimet e zonjës T. Kurti (biletat me agjensinë Reisebüro & Printshop Gashi në Bernë)	303.00	Ditët e Filmit Shqiptarë
5.	Shpenzimet për zotërinjtë Tolaj/Blyta (biletat Cyrih-Prishtinë me agjensinë Kosovareisen nga Cyrihu)	1'280.00	Projekti BAG
6.	Shpenzimet e lokalit për Kuvendin e dytë të rregullt në hotelin Löwen në Münsingen	375.50	
7.	Telefon & Fax ( 99 - 00 )	258.25	
8.	Shpenzimet e projektit "Migrants" (BAG) (Pagesat për ligjërues, për mbajtjen e tribunave)	7'120.00	Pagesat për ligjërues
9.	Shpenzimet e letrave, postës	136.05	
10.	Shpenzimet e Kuvendit të tretë të rregullt (ftesat, kokteji)	200.00	
11.	Materiali për sekretariat	132.45	
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme për vitin 2000:</b>		<b>20'105.25</b>	
<b>10.3. Bilanci i BISHZ për vitin 2000</b>			
<b>Saldoja për vitin 1999:</b>		<b>4'291.10</b>	
<b>Gjithsej të ardhurat hryëse për vitin 2000:</b>		<b>15'993.95</b>	
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme për vitin 2000:</b>		<b>20'105.25</b>	
<b>Saldoja për vitin 2000:</b>		<b>179.80</b>	



## 11. Lista aktuale e udhëheqësisë së BISHZ-së

<b>Nr.</b>	<b>Shkurtesa</b>	<b>Emri e mbiemri</b>	<b>Roli në BISHZ</b>	<b>Roli tjetër në BISHZ</b>
1.	<i>NJ</i>	<i>Nazmi Jakurti</i>	<i>Kryetar</i>	Udhëheqës i seksionit për çështje juridike
2.	<i>XHS</i>	<i>Xhevat Salihu</i>	<i>Nënkryetar</i>	Udhëheqëse e seksionit për shëndetësi; Anëtar i Komisionit Statutar
3.	<i>SSH</i>	<i>Sinollah Shehu</i>	<i>Sekretar</i>	Udhëheqës i seksionit për përkthime
4.	<i>IR</i>	<i>Ismet Rexhaj</i>	<i>Arkëtar</i>	Udhëheqëse e seksionit për ekonomi
5.	<i>AX</i>	<i>Ahmet Xhigoli</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës i seksionit për veprimtari botuese; Kryetar i Komisionit Statutar
6.	<i>LP</i>	<i>Lolita Poda</i>	<i>Këshilltare</i>	Udhëheqës e seksionit për arsim; Anëtare e Komisionit i kontroll-revizionit
7.	<i>AA</i>	<i>Arbër Ahmetaj</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës e seksionit për informim; Anëtar i Komisionit Statutar
8.	<i>FM</i>	<i>Fahri Mahalla</i>	<i>Këshilltar</i>	Udhëheqës i seksionit për sport; Kryetar i Komisionit i kontroll-revizionit
9.	<i>AF</i>	<i>Abas Fejzullahi.</i>	<i>Këshilltar</i>	Zëvendësdhëheqës i seksionit për kulturë; Anëtar i Komisionit i kontroll-revizionit
10.	<i>AM</i>	<i>Adnan Mehmeti</i>	<i>Administrator në Sekretariat</i>	
11.	<i>LB</i>	<i>Llokman Beqiri</i>	<i>Administrator në Sekretariat</i>	
12.	<i>SR</i>	<i>Shkumbin Rmoku</i>	<i>Administrator në Sekretariat</i>	